



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	07. 04. 2021	1	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHOK	1649/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.140/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.140/2021 të datës 15.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Xhemajl Mustafa”, BB 9/1; Hyrja 5/26, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.140/2021 e datës 15.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 15.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është regjistruar më numër protokoli:1150/2021, me pretendimet ankimore se i njëjti punon me kujdestari gjatë natës, punon gjatë vikendeve si dhe gjatë festave zyrtare dhe për punën e bërë nuk kompensohet shtesë siç e përcaktojnë dispozitat ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Më datë 23.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës e datës 15.03.2021 më numër protokoli:1150/2021; Akt Emërimit e ankuesit të datës 31.07.2013 me numër Prot:



210/2013; Kontratën e themelimit të marrëdhënies së punës të datës 29.04.2011 me numër Prot:229/2011; Vendimin e datës 26.07.2011 me numër Prot:221/2011; Kopjen e konkursit të datës 27.05.2011 i publikuar në gazetën “Epoka e Re”; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin shtator 2020 e datës 25.09.2020 me numër Prot; 246; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin shtator 2020 e datës 31.08.2020 me numër Prot:219; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin tetor 2020 e datës 14.10.2020 me numër Prot:269; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin tetor 2020 e datës 08.10.2020 me numër Prot:264; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin tetor 2020 e datës 30.09.2020 me numër Prot:255; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin nëntor 2020 e datës 30.10.2020 me numër Prot:286; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin dhjetor 2020 e datës 14.12.2020 me numër Prot:322; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin dhjetor 2020 e datës 02.12.2020 me numër Prot:311; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin janar 2021 e datës 25.01.2021 me numër Prot:041; Listën e orarit të kujdestarisë për zyrtarët e Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për muajin janar 2021 e datës 11.01.2021 me numër Prot: 12; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.03.2021 me numër protokolli:1217/2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 23.03.2021 me numër protokolli: 1327; Akt Emërimit e ankuesit të datës 31.07.20213; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë e ankuesit “Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave”; Listën e vijueshmërisë në punë për ankuesin për periudhën kohore prej datës 02.10.2020 deri më datë 25.02.2021; Shkresën për orët e realizuara në vendin e punës për muajt shtator-tetor-nëntor-dhjetor të vitit 2020 dhe për muajt janar-shkurt 2021; Ankesën e ankuesit të datës 29.11.2011; Vendimin e Komisionit për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave numër:8 të datës 08.12.2011; Procesverbali i seancës kryesore të datës 08.12.20211; Ankesën e ankuesit të datës 12.01.2012; Përgjigjen në ankesë të datës 13.01.2012; Ankesën e datës 12.01.2012; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër: Nr.02.05.2012; Aktvendimin për papranueshmëri për rastin nr. KI117/16 e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të datës 05.06.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi si dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në bazë të Akt Emërimit me numër: Nrprot:210/2013 të datës 31.07.2013 mbanë pozitën “Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave” në Këshillin e Sigurisë së Kosovës me kohë të pacaktuar, ndërsa në bazë të Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër Nr.prot:229/2011 të datës 29.07.2011 ankuesi marrëdhënien e punës e ka themeluar që nga data 01.08.2011 në Këshillin e Sigurisë së Kosovës sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në konkursin e shpallur të datës 25.05.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se ankuesi që nga themelimi i marrëdhënies së punës punon me kujdestari gjatë natës, punon gjatë vikendeve si dhe gjatë festave zyrtare dhe për punën e bërë nuk kompensohet me shtesë siç e përcaktojnë dispozitat ligjore respektivisht dispozitat e Rregullores Nr.20/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimin e Zyrtarëve Publik neni 4 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Orari i punës së nëpunësve

civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten”, ndërsa ka bashkangjitur edhe evidentimin e numrit të orëve që ka kujdestaruar për periudhën kohore gjatë muajve shtator-tetor-nëntor dhe dhjetor të vitit 2020 si dhe për muajt janar-shkurt të vitit 2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se në konkursin e publikuar të datës 25.05.2011 në gazetën “Epoka e Re”, disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarit për pozitën “Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave” kanë qenë të evidentuara si në vijim: “Duhet të jetë i/e gatshëm të pranojë përgjegjësi dhe punë jashtë orarit; Të jetë i/e gatshëm të punojë në bazë të rotacionit (të mbajë kujdestari) që caktohet nga Drejtori i Qendrës së Situatave”, si dhe shkresën e titulluar përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave” i nënshkruar nga udhëheqësi më i lartë administrativ i Këshillit të Sigurisë së Kosovës e datës 13.01.2014 është e përcaktuar qartë në pikën 12, nën-pika 5 se i njëjti: “Duhet të jetë i gatshëm të punojë në bazë të rotacionit (të mbajë kujdestari) që caktohet nga Drejtori i Qendrës së Situatave”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë neni 18 paragrafi 4 dhe neni 19 të cilët përcaktojnë, se: “Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë” dhe “Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”, si dhe dispozita e Ligjit Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës neni 1 paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të cilët përcaktojnë se: “1.1 Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e tij për stabilitetin rajonal. 1.2 Këshilli i Sigurisë i Kosovës rekomandon politika dhe strategji për sigurinë 1.3 Këshilli i Sigurisë i Kosovës duhet të ofroj informata dhe vlerësime të gjendjes së sigurisë në Kosovë, që t’i mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjet e sigurisë”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit si dhe provave që ka ofruar institucioni punëdhënës për organizimin e orarit të punës, numrin e orëve të ndërrimit të natës, punën gjatë vikendit dhe festave zyrtare, respektivisht orarin e kujdestarisë të Qendrës së Situatave për muajt shtator-tetor-nëntor dhe dhjetor të vitit 2020 si dhe orarin e kujdestarisë të Qendrës së Situatave për muajt, janar dhe shkurt të vitit 2021 si dhe në bazë të regjistrit të vijueshmërisë në punë për periudhën e lartcekur kohore është konstatuar fakti se ankuesi në raste të caktuara sipas orarit me rrotacion ka punuar kujdestari gjatë ndërrimit të natës, në raste të caktuara edhe gjatë vikendeve dhe festave zyrtare, mirëpo në secilin rast pas ndërrimit të natës ankuesi për dy ditët (48 orët) vijuese e ka pasur pushim, madje edhe kur pas ndërrimit të natës ka rezultuar të jetë ditë vikendi pushimi është bartur në ditët vijuese të punës, ngjashëm është vepruar edhe në rastet kur është punuar ditëve të vikendit dhe gjatë festave zyrtare, andaj duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.20/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimin e Zyrtarëve Publik neni 4 paragrafi 5 i cili përcakton se: “Në raste të veçanta, kur diktohet nga nevoja specifike të punës, institucionet të cilat kanë të punësuar mund të përcaktojnë një orar të ndryshëm nga ai në paragrafin 1 të këtij neni. Në çdo rast orari nuk mund të kalojë dyzet (40) orë punë në javë dhe 12 orë në ditë, ku përfshihet një (1) orë pushim”, pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase ankuesi nuk e ka kaluar asnjëherë numrin prej 40 (katër dhjetë) orëve të punës gjatë javës, kujdestaritë zgjasin vetëm 12 (dymbëdhjetë) orë, orët e punës gjatë natës janë vlerësuar me shtesë prej 30 % (tridhjetë për qind)

të orëve zyrtarë të ditës, po ashtu kujdestaritë janë pjesë e procesit të punës për shkak të detyrave specifike siç e përcaktojnë dispozitat e lartcekura të Ligjit Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, si dhe në përshkrimin e detyrave të punës dhe vetë konkursin për praninë në pozitën “Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave” ankuesi ka qenë i njoftuar paraprakisht për natyrën e punës në këtë institucion, andaj me rastin e nënshkrimit të Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër Nr.prot:229/2011 të datës 29.07.2011 kur e ka themeluar marrëdhënien e punës si dhe me rastin e nënshkrimit të Akt Emërimit me numër: Nrprot:210/2013 të datës 31.07.2013 ankuesi i ka pranuar si të mirëqena, natyrën-kujdestarinë, detyrat dhe përgjegjësitë e punës dhe si e tillë ankesa e ankuesit është e refuzuar si e pabazuar.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, në bazë listës së vijueshmërisë në punë-regjistrimit elektronik, ka konstatuar se ankuesi për dy muajt e fundit, janar dhe shkurt të vitit 2021 nga periudha kohore ndërmjet datave 01.01.2021 deri me datë 25.02.2021 ka të evidentuara 21 (njëzetënjë) hyrje në vendin e punës, ndërsa ka të evidentuara vetëm 1 (një dalje) nga vendi i punës, andaj me këtë rast ankuesi si dhe institucioni punëdhënës kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.20/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimin e Zyrtarëve Publik neni 8, paragrafët 1, 2 dhe 3 të cilët përcaktojnë se: “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik është menaxheri drejtues”, ngase regjistri i vijueshmërisë në punë është rrethanë apo fakt vendimtar që vërteton prezencën dhe orët e realizuara të punës së nëpunësit civil në vendin e tij të punës sipas detyrave dhe përgjegjësisive të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.140/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.